UDHËZIM
Nr. 2, datë 2.2.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 12, DATË 15.7.2014, "PËR PËRCAKTIMIN E TREGUESVE TË SIGURISË DHE CILËSISË SË MIELLIT TË GRURIT TË PARAPAKETUAR, PËR T'U SHITUR TE KONSUMATORI I FUNDIT OSE PËR PRODHIMIN E PRODUKTEVE TË TJERA USHQIMORE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 12, datë 15.7.2014, "Për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe cilësisë së miellit të gurit të parapaketuar, për t'u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore", në tabelën e shtojcës II, "Kufiri i lejuar dhe metoda e analizimit për disa tregues të miellit të gurit", kufiri i lejuar për proteinën (Nx5,7) mbi bazën e peshës së thatë është 12.5% dhe bëhet 9%.

2. Dispozita e pikës 1 të këtij udhëzimi është e vlefshme deri më 1 maj 2015.

3. Ngarkohen Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT
RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE
Edmond Panariti